



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 804/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Arton Gaxherri kandidat për kuvendin komunal në Junik nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Junik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Arton Gaxherri kandidat për kuvendin komunal në Junik nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Junik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpallje së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 20:05, ka pranuar një apel nga Arton Gaxherri kandidat për kuvendin komunal në Junik nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Junik në të cilin thekson se rezultatet e tij në Junik në dy vendvotime nuk janë ato të cilat e kanë votuar votuesit e tij. Parashtruesi i apelit thekson se nuk i janë numëruar votat me rregull dhe dyshon se ka mos përputhje të votave në vendvotimin 3101C/05R.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të provave, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërin e votave për të cilat pretendon se i mungojnë.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara për shkak te mungesës se dëshmive lidhur me pretendimet e parashtruara ne apel dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.804/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.